



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MIRANDA F. XHEMALÇE  
ADRESA Bulevardi "Zhan D'Ark",  
Pallati 21/1, Shkalla 1, Apartamenti 1  
TEL: 682044339

## VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 3631

Nr. koleksioni: 830/2

Tirane më 26/08/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"



A2021053270095919583

\*Akti noterial përbëhet nga 5 fletë



A2021053270095919583

## LËSHIMI I DËSHMISË SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Në Tiranë, sot më datë 26.08.2021, unë notere publike **Miranda F. Xhemalçe**, notere pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë noteriale në Blvd. "Zhan D'Ark", Pallati 21/1, Shkalla 1, Apartamenti 1, Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e shkruar dhe dokumentacionin përkatës, të paraqitur nga:

**Kërkues/e:** **Kristaq Tase**, atësia Viktor, amësia Theana, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Mihal Grameno; Nd. 114; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1004; Tiranë, lindur më 08/10/1946, gjendja civile "i ve", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033832477 dhe nr. personal E61008051B të plotë për të vepruar, në cilësinë e trashëgimtarit, si bashkëshorti i trashëgimlënësës.

**Objekti:** **Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore** për trashëgimlënësen **Katerina Tase**, atësia Kristofor, amësia Ermioni, lindur më datë 17.03.1953, në Përmet, gjinia femër, me status civil e martuar, me shtetësi shqiptare, me vendbanim të fundit në Tiranë, Njesia Administrative nr.1, Tiranë, vdekur më datë 20.05.1996, në Tiranë.

**Baza Ligjore:** Nenet 348, 360 e 361 të Kodit Civil  
Neni 62, gërma "d", si dhe nenet 111 e 112 të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018, "Për Noterinë"

Unë noterja, pasi administrova provat shkresore të paraqitura,

### VËREJ:

Se kërkuesi Kristaq Tase, me identitet si më sipër, në cilësinë e trashëgimtarit/ është bashkëshorti i **Katerina Tase**, atësia Kristofor, amësia Ermioni, lindur më datë 17.03.1953, në Përmet, gjinia femër, me status civil e martuar, me shtetësi shqiptare, me vendbanim të fundit në Tiranë, Njesia Administrative nr.1, Tiranë, vdekur më datë 20.05.1996, në Tiranë..

Referuar Certifikatës së sipërpërmendur, rezulton se e ndjera Katerina Tase, ka patur si vendbanim të fundit në Njësinë nr.1, të Bashkisë Tiranë, njësi vendore në të cilën unë, noteri, ushtroj profesionin.

Në zbatim të përcaktimeve të nenit 348 (të ndryshuar) të Kodit Civil në të cilin përcaktohet se, "Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet nga noteri i njësisë vendore ku ka patur vendbanimin e fundit trashëgimlënës", unë noteri gëzoj kompetencën territoriale për trajtimin e trashëgimisë ligjore të të ndjerës Katerina Tase, pasi provohet se ka patur si vendbanim të fundit (Njësia bashkiake nr. 1.) në Bashkinë Tiranë.

Trashëgimlënësja Katerina Tase, rezulton të ketë qenë e martuar me Z.Kristaq Tase, me nr. personal E61008051B, atësia Viktor, amësia Theana, lindur më datë 18.10.1946, në Tiranë, me status civil i ve,



A2021053270095919583

me shtetësi shqiptare, me vendbanim në "Mihal Grameno" Tiranë. (të dhënat referuar Certifikatës Personale)

Bashkëshortët kanë lidhur martesë më datë 01.09.1975, të dy me gjendje civile beqarë në kohën e lidhjes së martesës, referuar Certifikatës së Martesës (nga Akti) nr.017542970, datë 16.08.2021, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile (Arkiva) Bashkia Tiranë. Sipas deklarimeve të kërkuarit Kristaq Tase, dy bashkëshortët kanë patur **regjim pasuror pasmartesor të pacilësuar**.

Gjithashtu, Certifikata Familjare, në bazë të Regjistrimit Themeltar të vitit 1974, me nr. 017510358, datë 16.08.2021, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake Nr. 1 gjendja familjare e vitit 1991; Certifikata Familjare, në bazë të Regjistrimit Kombëtar të vitit 1974, me nr.017510357, datë 16.08.1951, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia bashkiake nr. 1, gjendja familjare e vitit 1996; Certificate familjare në bazë të regjistrimit kombëtar të vitit 2010, nr. serie 017529656, datë 11.08.2021, rezultojnë nga kjo martesë, bashkëshortët kanë 2 (dy) fëmijë, përkatësisht:

1. **Ermal Tase**, me nr. personal H60815150P, atësia Kristaq, amësia Katerina, lindur më datë 15.08.1976, në Tiranë, me vendbanim në "Mihal Grameno" Tiranë, gjinia mashkull, me status civil i martuar, me shtetësi shqiptare, sipas Certifikatës Personale nr. 017529658, datë 11.08.2021, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njesia Administrative nr.2.
2. **Donald Tase**, me nr. personal H80727184D, atësia Kristaq, amësia Katerina, lindur më datë 27.07.1978, në Tiranë, me vendbanim në Rruga "Mihal Grameno" Tiranë, gjinia Mashkull, me status civil i martuar, me shtetësi shqiptare, sipas Certifikatës Personale nr. 017529659, datë 11.08.2021, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njesia administrative nr 2.

E ndodhur në kushtet e plotësimit të kriterit për kompetencën territoriale për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësës Katerina Tase, e cila ka patur vendbanimin e fundit në Bashkinë Tiranë, unë notere e Degës Vendore Tiranë, kërkoja nga Dhoma Kombëtare e Noterisë të kontrollohej në **Regjistrin Kombëtar të Testamenteve dhe Regjistrin Kombëtar të Dëshmive të Trashëgimisë** nëse trashëgimlënësja ka lënë më parë testament ose nëse është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore apo testamentare për të, nga një noter tjetër.

Për kërkesën nr.1385-190 është marrë përgjigja e datës 23.08.2021, nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, ku shprehet se "Nga verifikimi i Regjistrimit Kombëtar të Testamenteve, nuk rezultojnë që trashëgimlënësi të ketë disponuar me testament gjatë gjallërisë së tij/të saj, dhe ju konfirmojmë se mund të vijoni me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin/en Katerina Tase.. Për këtë arsye, legjitimohet vijimi i procedurës për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësen.

Me vdekjen e saj, në zbatim të nenit 317 të Kodit Civil, ku përcaktohet se "Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament ose ka bërë vetëm për një pjesë të pasurisë së tij ose kur testamenti është tërësisht apo pjesërisht i pavlefshëm", zbatohet trashëgimia ligjore e rregulluar kjo konkretisht nga nenet 360 e vijues të Kodit Civil. Suksedimi i pasurisë në këtë rast realizohet ndaj subjekteve, që ligji ka identifikuar si trashëgimtarë ligjor dhe sipas një radhe plotësisht të përcaktuar.

Gjatë shqyrtimit, kërkuari/ja Kristaq Tase, deklaroi se trashëgimlënësja Katerina Tase;

- Nuk ka trashëgimtarë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim;



A2021053270095919583

- Nuk ka trashëgimtarë të shpallur të padenjë për të trashëguar;
- Nuk ka trashëgimtarë që të kenë hequr dorë nga trashëgimia;
- Nuk ka trashëgimtarë që të jenë përjashtuar nga trashëgimia;
- Nuk ka patur fëmijë jashtë martese apo të birësuar

Gjithashtu, nga informacioni që disponohet, nuk ka të dhëna që trashëgimlënësja të ketë bërë parashikime mbi rregullimin e legut dhe barrës.

Në këto kushte, kërkuesi/ja Kristaq Tase, deklaroi se, **për efekte pasurore dhe ligjore, kërkon lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësen Katerina Tase;**

#### **Arsyetimi ligjor:**

##### Kriteret për shqyrtimin e kërkesës.

Objekti në çështjen konkrete gjen bazë ligjore në dispozitat materiale të Kodit Civil, dhe konkretisht në nenin 348 (të ndryshuar) i këtij ligji, i cili parashikon se: *“Cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese në trashëgimi caktohen në dëshminë e trashëgimisë, të lëshuar nga noteri, pas paraqitjes së certifikatës së vdekjes së trashëgimlënësit, sipas rregullave të caktuara në këtë kod dhe në ligjin “Për Noterinë””*.

Për këtë arsye, identifikova **legjitimitetin** e kërkuesit/es. Legjitimiteti në këtë rast nënkupton lidhjen që duhet të ekzistojë midis kërkuesi/es dhe pasojave juridike që passjell fakti dhe vërtetimi i tij nga noteri. Nisur nga përcaktimi se lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë është procesi, përmes të cilit formohet prova për ekzistencën e faktit juridik dhe përcaktimin e pasojave ligjore që rrjedhin prej tij, konkludova se subjekti që paraqet kërkesën, gëzon legjitimitet. Ekzistencën e interesit kërkuesi/sja e vërtetoi përmes provave shkresore të paraqitura si Certifikatat Familjare të viteve 1950-1974 dhe viteve 1974, 2010, prej të cilave vërtetohet se kërkuesi Kristaq Tase, është bashkeshorti i trashëgimlënëses Katerina Tase.

Në këto kushte, plotësohet kriteri për shqyrtimin e kërkesës civile të kërkuesit/es të legjitimuar si person që ka interes për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së trashëgimlënëses Katerina Tase.

##### Përcaktimi i trashëgimtarëve ligjore dhe pjesëve ideale të pasurisë trashëgimore për secilin trashëgimtar.

Trashëgimia është marrëdhënie juridike, që lind si rezultat i vdekjes dhe që formohet pas vdekjes. Synimi kryesor i lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë është vërtetimi i pasojave që sjell fakti juridik i vdekjes, fakt ky i konstatuar dhe i dokumentuar nga “Certifikata e Vdekjes” së të ndjerës Katerina Tase.

**Së pari**, në lidhje me **ligjin e aplikueshëm**, ligjvënësi e lidh momentin e vdekjes së trashëgimlënëses apo çeljes së trashëgimisë me përcaktimin e ligjit material të zbatueshëm për normimin e marrëdhënies juridike të trashëgimisë të krijuar. Ligji i zbatueshëm në rastin konkret është ligji material civil, që ka qenë në fuqi në kohën e ndërrimit jetë nga trashëgimlënësja. Përcaktimi i këtij ligji merr rëndësi në kuadër të përcaktimit të rrethit të trashëgimtarëve, të zotësisë së tyre për të trashëguar si dhe për përcaktimin e volumit të drejtave dhe detyrimeve, që suksedohen ndaj secilit trashëgimtar.

Duke iu referuar datës së vdekjes së trashëgimlënëses më 20.5.1996 rezulton se i aplikueshëm për rregullimin e kalimit të pasurisë së trashëgimlënëses është **Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”**, në nenin 318 të të cilit përcaktohet se, *“Trashëgimia çelet kur vdes trashëgimlënësi dhe në vendin ku ai ka patur vendbanimin e tij të fundit”*. Nga ky rregullim ligjor



A2021053270095919583

rezultojnë se efekti juridik i vërtetimit të faktit juridik të vdekjes është **çelja e trashëgimisë**, moment nga i cili lindin edhe të drejtat dhe detyrimet e trashëgimtarëve mbi pasurinë trashëgimore.

Së dyti, në **lidhje me përcaktimin e trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënësës**, në rastin konkret unë noteri **Zbatova nenet 360, 361 të Kodit Civil** duke respektuar edhe rregullin e vendosur nga neni 369 i këtij kodi, ku përcaktohet se, *“trashëgimtarët e radhës së mëpasme thirren në trashëgim vetëm kur nuk ka trashëgimtarë të radhës së mëparshme ...”*. Përkatësisht, në nenin 361 të Kodit Civil parashikohet se: *“Në radhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta.”*

Sipas të dhënave të disponuara nga Certifikata e Martesës (nga Akti) dhe Certifikatat Familjare, të trashëgimlënësës Katerina Tase, rezultojnë që trashëgimtarë ligjorë të saj të jenë përkatësisht:

1. **Kristaq Tase**, me nr. personal E61008051B
2. **Ermal Tase**, me nr. personal H60815150P,
3. **Donald Tase**, me nr. personal H80727184D

Për të identifikuar në mënyrë të saktë nga pikëpamja ligjore trashëgimtarët e trashëgimlënësës Katerina Tase, verifikova edhe kushtin tjetër të domosdoshëm të kërkuar nga ligji material i aplikueshëm në rastin e kësaj marrëdhënie trashëgimie, pra **zotësia për të trashëguar**. Si kriter për të gëzuar zotësinë për të trashëguar, në nenin 320 të Kodit Civil ligjvënësi ka përcaktuar se *“Ka zotësi për të trashëguar personi që në kohën e çeljes së trashëgimisë është gjallë”*. Referuar Certifikatave Personale, rezultojnë se në kohën e çeljes së trashëgimisë janë gjallë bashkëshorti dhe dy fëmijët.

Gjithashtu nga deklaratimet e kërkuarit/es, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, përjashtohet çdo lloj **situatë penguese** për të fituar trashëgiminë, pasi:

- Trashëgimtarët nuk rezultojnë të jenë të padenjë për të trashëguar (në kuptim të nenit 322 të Kodit Civil), të jenë përjashtuar (neni 378 i Kodit Civil) apo të kenë hequr dorë nga trashëgimia (neni 333 i Kodit Civil).
- Nuk rezultojnë që trashëgimlënësja të kishte fëmijë jashtë martesë apo të birësuar.

Së treti, neni 361 i Kodit Civil përcakton edhe **pjesët ideale të pasurisë trashëgimore** në të cilat trashëgon secili prej trashëgimtarëve konkurrues të radhës së parë. Referuar kësaj dispozite ligjore ku përcaktohet se *“Në radhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta”*, si dhe në analizë të akteve provuese, duke qenë se rezultojnë si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë: **bashkëshorti dhe dy fëmijët**, konkretisht secili prej trashëgimtarëve do të përfitojë **1/3 (një të tretën)** pjesë nga pasuria trashëgimore të trashëgimlënësës Katerina Tase dhe po në këtë masë do të përgjigjen për detyrimet që rrjedhin nga kjo pasuri, deri në vlerën e pasurisë që kanë trashëguar (neni 341/1).

Në përfundim të arsytimit të mësipërm, unë noteri e vlerësoj të drejtë, të bazuar në ligj dhe në prova kërkesën e kërkuarit/es Kristaq Tase, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësen Katerina Tase;

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 317, 318, 318/1, 318/2, 341, 348, 360, 361, 369 të Kodit Civil, të ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018, “Për Noterinë”;





A2021053270095919583

**VENDOSA:**

- Pranimin e kërkesës.
- Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësen Katerina Tase ,duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të saj:

1. **Kristaq Tase**, me nr. personal E61008051B - bashkëshorti
2. **Ermal Tase**, me nr. personal H60815150P, - i biri
3. **Donald Tase**, me nr. personal H80727184D- i biri

të cilët trashëgojnë secili nga 1/3 (një të tretën) pjesë të pasurisë trashëgimore dhe po në atë masë përgjigjen për detyrimet që rrjedhin nga kjo trashëgimi.

- **Dëshmia e trashëgimisë nuk mund të cenojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës.**
- **Dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, nuk mund të cenojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës. Nëse trashëgimlënësi ka pasuri bashkëshortore të përfituara përgjatë martesës, por të regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, vetëm në emrin e tij, regjistrimi i pjesës takuese të trashëgimisë ligjore do të bëhet duke zbritur 1/2 pjesë të prezumuar të bashkëshortit pasjetues, në referim me nenin 76 të Kodit Civil, nenit 112, pika e ligjit 110/2018 “Për Noterinë”. Gjithashtu nëse trashëgimlënësi është i prezumuar bashkëpronar në ndonjë nga pasuritë e regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, atëherë, pjesa e prezumuar e bashkëpronësisë së tij do të kalojë tek trashëgimtarët ligjorë sipas pjesëve takuese.**
- **Bashkëlidhur dëshmisë së trashëgimisë, gjendet Certifikata e Martesës së lidhur midis trashëgimlënëses Katerina Tase dhe bashkëshortit krustaq Tase.**
- **Dëshmia e trashëgimisë duhet të regjistrohet nga kërkuesi/ja brenda 30 ditëve nga dita e lëshimit të saj në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, në autoritetin përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme për Qarkun e Tiranës, si dhe në çdo zyrë tjetër përgjegjëse për qarqet ku janë të regjistruara pronat në emër të trashëgimlënëses, në rast të kundërt për çdo ditë vonesë pas afatit 30 ditor, paguhet gjobë.**
- **Kundër këtij akti mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, referuar Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018, “Për Noterinë”.**
- **Akti përbëhet nga (5) faqe dhe lëshohet në 5(pese) kopje me fuqi të njëjtë juridike, ku njëra kopje qëndron në arkivën e Zyrës Noteriale, një kopje për institucionin përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nga një kopje për trashëgimtarët ligjorë.**
- **Shpenzimet noteriale të përcaktuara nga Urdhri Nr. 306, datë 31.07.2013, i Ministrit të Drejtësisë, janë në ngarkim të kërkuesit/es.**

Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore kryhet sot më datë 26.08.2021 në Tiranë dhe regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të lëshimit të dëshmimeve të trashëgimisë ligjore.

**NOTERE**  
**MIRANDA XHEMALÇE**

**NOTERE**  
**MIRANDA XHEMALÇE**  
**DANË ALBANIA**